



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë , nr. 03/L-48 dhe nenit 34.2 shkronja b, të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2015, miratoi këtë,

## **VENDIM**

### **PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS NGA VITI 2014 NË VITIN 2015 DHE DESTINIMIN NË KATEGORI TË CAKTUARA BUXHETORE**

#### **Neni 1**

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës, të pashpenzuara në vitin 2014, në shumën 297.039,51 € barten në vitin 2015, në programet si vijon:

- Administratë Komunale.....	153.681,46 €
- Shëndetësi .....	14.465,50 €
- Arsimit .....	128.892,55 €

Mjetet e cekura destinohen në kategoritë e caktuara ekonomike sipas specifikacionit i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 2**

Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 02-400-24554**  
**Podujevë,**  
**27 shkurt 2015**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**